



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **28.04.2026**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Fatmir Iska**. Kryesuesi konstatoi se, kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 27 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 27.

Kryesuesi: Përhëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, përshëndetje për asambleinë e të rinjve, drejtorë të drejtorive komunale, sekretari e kuvendit, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medie dhe ju të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Kjo është mbledhja e katërt dhe në bashkëpunim me kryetarin kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 21/140 Nr. i faq./Br.str./No.pg 87

Data/Datum/Date 29.09.2026

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajshme të komunës,
P-O-71510057-106-0-2-0,
P- O-71510057-106-0-3-0,
P- O-71510057-106-0-4-0,
P- O-71510057-106-0-8-0,
P- O-71510057-106-0-9-0 dhe
P- O-71510057-106-0-10-0, ZK-Rahovec;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajshme të komunës,
P- O-71510057-106-0-2-0,
P- O-71510057-106-0-3-0,
P- O-71510057-106-0-4-0,
P- O-71510057-106-0-8-0,
P- O-71510057-106-0-9-0 dhe
P- O-71510057-106-0-10-0, ZK-Rahovec;
4. Shqyrtimi i raportit financiar janar-mars 2026;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për Taksa Komunale;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për Procedurat dhe Kriteret e Ndërtimit në Komunën e Rahovecit;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin, përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shërbime Publike;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin, përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Mbrojtje, Shpëtim dhe Emergjencë;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajshme komunale, P- 71510033-00772-10 Z.K. - Xërxë - Gradish - Base Friends LLC;
11. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.

Kryesuesi: Po e hapi debatin rreth rendit të ditës!

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, anëtarë të kuvendit komunal, nxënës të pranishëm, medie, qytetarë. Para se të fillojë seanca, kryesuesi është mirë të konstatojë nëse do të realizohet në plotni, sepse përsëri kemi pasur pengesa në seancën paraprake. Në mbledhjen e KPF-së, kam kërkuar nga ekzekutivi një informatë rreth lokaleve të palestra, që tani e kemi në rend dite. Kam kërkuar informacione se kush i ka ato lokale në shfrytëzim, sa është përmbushur kontrata, sa është vlera e qirasë. Këto informacioni nuk i paska materiali që na keni dërguar. A do ta jep tani këto informacione drejtoria përgjegjëse? Gjithashtu, vendimi që është kthyer nga MAPL është mirë të tërhiqet nga rendi i ditës, sepse janë konstatuar disa shkelje ligjore. Sa më kujtohet, Defrimi ka qenë anëtar i këtij komisionit. Ndër të tjera thotë që, përveç që nuk janë zbatuar kriteret, afati i dhënies në shfrytëzim i pronës komunale në afat prej 15-99 vjet, është me shprehje të interesit, ndërsa komisioni ka vazhduar me ankand publik, gjë që është shkelje. E pashë edhe raportin që na keni dërguar, aty ishte e ndryshuar, pra, nga ankand publik është bërë në shprehje të interesit. Në momentin që hyra të thirrja që e keni bërë, e vërejtja që aty ishte “ankand publik” dhe kjo është një ndër shkeljet që e keni bërë. Gjithashtu, te lista e dhënies në shfrytëzim të pronave të përgjithshme dhe të veçanta, aty thotë që nuk është respektuar ligji, pasi që nuk janë zbatuar kriteret. Është mirë ta sqarojmë në mënyrë që ministria mos të na kthejë përsëri këtë vendim. Dallimi në mes ankandit publik dhe shprehjes së interesit është ky: Ankandi publik nënkupton procesin e konkurrencës së hapur, ku fituesi zgjidhet në bazë të çmimit më të lartë të ofruar dhe në raste specifike të kriterëve të përcaktuara në ankand (1-15 vite). Shprehja e interesit nënkupton procesin e konkurrencës së hapur, ku fituesi zgjidhet në bazë të kriterëve të specifikuar në thirrje. Prandaj, është mirë që ta tërheqim këtë pikë të rendit të ditës dhe të specifikohet qëllimi i dhënies në shfrytëzim të kësaj prone, sepse te lista e dhënies në shfrytëzim të pronave thuhet se është tokë bujqësore, ndërsa këtu jepet për veprimtari biznesore.

Enis Durguti: Përsëritje për të gjithë dhe përsëritje speciale për mysafirët që i kemi këtu nga shkolla. Kryesues, nëse të kujtohet, në seancën e kaluar kam diskutuar për raportet e komisioneve, në veçanti për komisionin e Hotel Park Plazës, për tregun e hapur (qendrën tregtare) dhe për lokalitë të qytetit. Nëse bën të na informoni rreth raportet e komisioneve. Këtu ne material nuk po e shoh asnjë raport të asnjë komisioni, ndërsa, po e shoh që ka pasur lëvizje të lokalitë të parkut të qytetit dhe është mbyllur ankandi. Ne nuk kemi informata zyrtare, është mirë t'i kemi këto informata si anëtarë të kuvendit.

Jusuf Dërmala: Në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës, te lokalitë numër 106-0-8-0. Këtu e kemi një fitues në mars të vitit 2025, realisht kur është shpallur raporti publik. Fituesi në fjalë nuk ka nënshtruar kontratë. Kërkoj informacion nëse është njoftuar fituesi i këtij ankandi për nënshtrimin e kontratës dhe a ka ftesë zyrtare, si dhe pse nuk i është dhënë në afat kohor brenda 15 dite (afati ligjor)?!

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë, kolegë asambleist, nxënës të pranishëm, zyrtarë komunalë, media dhe të gjithë ata që po na përcjellin. Meqenëse Lirigzoni ma përmendi emrin, e kam obligim dhe përgjegjësi ta marrë fjalën. Gjithashtu, edhe unë jam kundër që kuvendi të marrë vendim në lidhje me këtë parcelë. Është formuar komisioni dhe me vendim të kuvendit kjo pronë është votuar për t'u dhënë në shfrytëzim. Nuk besoj që është e arsyeshme që kuvendi përsëri ta marrë një vendim tjetër për ta dhënë në shfrytëzim. Në materialin që e kemi, në vendimi i kuvendit i nënshtruar prej kryesuesit në mandatin e kaluar thuhet: pika 1, miratohet propozimi i kryetarit të komunës, i datës 13.08.2024 dhe merret vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës, personave fizikë dhe juridikë deri në 20 vjet përmes procedurës së shprehjes së interesit. Tani kuvendi e ka përfunduar punën për këtë parcelë, pavarësisht që MAPL-ja

e ka kthyer vendimin e komisionit dhe jo vendimin e kuvendit. Kjo parcelë tani duhet t'i nënshtrohet procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe për mënyrën se si, duhet të vendosë komisioni i ri. Nuk kemi një precedent tjetër, që kuvendi i komunës e ka marrë një vendim që direkt me vendim të kuvendit t'i jepet në shfrytëzim personit fizik ose juridik. Unë kam qenë pjesë e komisioni, e kemi marrë një vendim dhe tutje nuk e di se si janë zhvilluar procedurat. Besoj që është i vlefshëm vendimi i kuvendit i mandatit të kaluar.

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit. Në lidhje me vendimin e përmendur nga asambleisti Lirigzoni dhe Defrimi: Shkresa e MAPL-së e thotë qartë që gjatë hartimit të venditmit në nenin 1 të vendimit, i cili është marrë para vitit 2026 e ka gjetur një gabim. Këtë e din saktë Lirigzoni si jurist. Në nenin 1 të këtij vendimi thuhet që, merret vendimi që të japim me qira pjesë të parcelës nëpërmjet shprehjes së interesit. Te neni 2, ka mbetur një fjali në vendim “nëpërmjet ankandit publik”. Ka ndodhur një gabim teknik dhe MAPL e ka vërejtur dhe ka thënë: “parcelën duhet ta japësh përmes shprehjes së interesit, sepse ndryshe nuk bën”. Sipas ligjit, toka që jepet në shfrytëzim 15 vjet plus 1 ditë, jepet përmes shprehjes së interesit dhe në këtë rast procedurat dallojnë. Gabimi ynë është që ne e kemi shkruar “përmes ankandit publik” dhe krejt veprimet e tjera procedurale që i ka bërë Defrimi bashkë me neve kanë qenë në rregull, sepse kanë qenë përmes shprehjes së interesit. Përndryshe, mos të kishte qenë kështu, pas afatit të ankesave kryetari me përfituesit do ta kishin nënshtuar kontratën. Tani po ju themi juve, këto procedura që janë zbatuar në bazë të shprehjes së interesit, jo të ankandit publik, sepse ankandi publik na ka mbetur veç në raport dhe ky është gabimi që e ka gjetur MAPL-ja dhe ka thënë përmirësoje. Defrim, nuk ka vendim të ri, por është vendimi i njëjtë që është marrë në kuvend dhe që e ka marrë ligjshmërinë e MAPL-së. Ministria po thotë që përveç publikimit të listave të pronave që dëshirojmë t'i japim në shfrytëzim, duhet të ceket edhe afati kohor që jepet në shfrytëzim, si dhe tani thonë që duhet edhe destinimi i parcelës. Tani, krejt që ata po kërkojnë prej neve është që të plotësohet-ndryshohet raporti dhe t'ju përcjellim përsëri atyre, sepse procedurat e mëhershme kanë ligjërisht në rregull.

Lirigzon Kastrati: Drejtor, ke qenë anëtar i komisionit. Thirrjen kur e keni bërë në 2025, e keni bërë me “ankand publik”, edhe pse specifikisht ligji të thotë që duhet me “shprehje të interesit”. Nuk e di pse thua që ka qenë në rregull edhe më herët. Raportin e paske ndryshuar, është e vërtetë. Mirëpo, thirrja kur ia ka filluar kjo procedurë ka qenë me “ankand publik”. Kjo thirrje është bërë nga ana e komunës, me propokol të Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme.

Defrim Kafexhiu: Raporti i komisionit është i protokoluar më 10 prill 2026 (raporti i ndryshuar). Në arsyetimin e MAPL-së për kthimin e vendimit në rishqyrtim nuk përmendet raporti. Përmenden nenet ku është bërë gabim, por jo në raport. Në parim jam “për” dhënies në shfrytëzim, por forma e dhënies në shfrytëzim më duket që krijon precedent të ri. Raporti është në rregull dhe ky zotëriu e ka fituar procedurën sipas thirrjes së komisionit. Pse kuvendi ta votojë këtë ndryshim të raportit?

Afrim Oruqi: Defrim, e kemi edhe një herë në kuvend, sepse dallojnë procedurat kur është deri në 15 vjet dhe kur është deri në 99 vjet. Sipas ligjit, obligohemi në kuvend edhe një herë, sepse kur është shprehje e interesit merret vendimi dhe mund të aplikojnë më shumë se 1 dhe komisioni me raport vendosë për fituesin, si dhe ia kthen kuvendit raportin e shpalljes së fituesit me detaje. Kuvendi e aprovon raportin dhe e nxjerrë vendimin. Kështu ka qenë edhe më herët, sepse kështu është me ligj dhe kështu përsëri do të veprojmë kështu. Lirigzon, të dytë po e dimë që kemi gabuar me shkrim në raport. Lirigzoni gjithashtu e din se cili ka fuqi ligjore më shumë, vendimi apo raporti? Në vendim është mirë, në pikën 1 të vendimit thotë “me shprehje të interesit”. Pra, është gabim teknik. MAPL ka thënë që ta përmirësojmë, sepse të gjitha procedurat kanë qenë rreth shprehjes së interesit.

Kryetari: Kryesues i nderuar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit, medie, pjesëmarrës fëmijë nga asambleja e fëmijëve, KFOR-i, nënkryetar. Besoj që sqarim më të qartë vështirë është të gjejmë. Tjetër herë është mirë që mos të kemi gabime teknike, sepse edhe një gabim i tillë teknik po na vonon në proces. Sa i përket lokaleve te palestra, është e vërtetë që ekziston një afat për nënshtimin e kontratës dhe nuk dua të futem në detaje, a është 10 a po 15 ditë.

Dikush ka hezituar të vij ta nënshkruar kontratën, që në fakt e ka fituar. Gjithashtu, unë nuk e kam atë kapacitet që t'ia mbushi mendjen dikush dhe t'i them "eja nënshkruaje kontratën" kur i njëjti e ka ditur që e ka fituar ankandin. Ai ndoshta i ka pasur disa dilema të natyrave të tjera. Dilemat kanë qenë: ndoshta më sheh dikush, ndoshta nuk do të kem punë dhe ndoshta nuk fitoj asgjë për shkak të ndërtimit të sheshit. Një herë kështu, një herë ashtu. Unë e di që mund të ketë proces ligjor (masë të përkohshme të sigurisë), por nuk ka asnjë problem, e presim finalen dhe nëse ai e fiton të drejtën jemi shumë në rregull. Nuk mund të jemi shkaktarë të njerëzve që kanë halucinacione, të njerëzve që nuk besojnë.

Jusuf Dërmala: Kjo fjalë është ofendim!

Kryetari: Nuk është aspak ofendim dhe të lutem mos më ndërhyj! Nëse e keni personale, atëherë liroje sallën e kuvendit, sepse unë po flas për qytetarët. Përderisa unë jam duke folur, të lutem asnjëherë mos më ndërhyj, sepse e keni foltoren këtu. Nuk e ofendova askënd! Vetëm thash që ka pasur dilema dhe halucinacione dhe ai vetë i ka shfaqur ato. Atë djalë për të cilin po flet, e njoh para teje! Mos u mundo t'i japësh asnjë lloj karakteri fjalës sime, sepse unë jam i vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm në atë që e them. Mos më ndërhyj, sepse mund t'i kërkoj kryesuesit të të nxjerrë jashtë nga salla. Nuk jemi këtu në Han të Kaçit, por jemi në kuvendin e komunës. Kërkoj një fije respekt. Unë nuk vij për ty këtu dhe mos u bën me logjikë fëmijërore. A e din që ka rregulla dhe norma këtu?! Kur e merr fjalën, atëherë më kritiko, por kurrë hiç nga vendi. Enis, do të ketë raportim të qartë për çdo aset, pasuri dhe pronë të komunës, të dhënë në shfrytëzim qoftë në afat të shkurtër, qoftë në afat të gjatë. Sa i përket Parkut të Qytetit, gjithçka është në përputhje me ligjin dhe brenda afatit ligjor do të ketë nënshtrim të kontratës. Ju ftoj ta votoni rendin e ditës, sepse janë pika të rëndësishme. Unë duhet të lëvizim për Prishtinë. Përndryshe, e admiroj drejtorin Afrim Oruqi, për sqarimet e tij.

Jusuf Dërmala: Pyetjen e kam bërë shumë qartë: A ka pasur ftesë prej komunës për nënshtrimin e kontratës, pasi e ka fituar ankandin? Këtu nuk mora përgjigje. Kryetar, sa i përket çështjes së ndërhyrjes, mos na moralizoj. Nuk ke nevojë të na moralizosh se kush si sillet këtu, sepse edhe unë e kam marrë votën e qytetarëve për të kërkuar përgjegjësi nga ju. Nuk jam votuar prej teje, por prej qytetarëve.

Kryetari: Për këtë çka e thash, unë të mbaj moral ty gjithë ditën dhe i jap të drejtë vetes. Të thash merre fjalën në foltore dhe mos më ndërhyj. Qytetarët të kanë zgjedhur ty, ashtu siç më kanë zgjedhur edhe mua. Ka norma në këtë vend dhe mungesa e disiplinës nuk të bën nder as ty, as qytetarëve. Po, ka pasur ftesë zyrtare prej ish-drejtorit Erhan Morina dhe jo vetëm një herë. Ka hezituar dhe, edhe njëherë po e them, ka pasur edhe halucinacione për këtë temë. Unë kam qenë i gatshëm ta nënshkruaj, ashtu siç e kam nënshtruar me të gjithë, si dhe nuk ka ndodhur kurrë që 12 vjet, që një fitues i një ankandi publik mos t'ia nënshtruar kontratën. Nëse ndërhysh edhe një herë, nuk të mbaj moral, por shkollë. Kuvendi në këtë rast nuk ka sigurim, sepse në këso raste, dikush duhet të dalë nga seanca, unë ose ai që ndërhysh.

Lirigzon Kastrati: Kryetar, edhe nëse ia bën hallall përgjigjen drejtorit, nuk e ka të saktë. Ishte përgjigje që të konvenon. Një sqarim: Rregullorja për dhënien në shfrytëzim thotë: "çmimi fillestar nuk vendoset te shprehja e interesit". Këtu në ankand publik vendosur kështu. Është gabim procedural, sepse nuk mund të thuash që është gabim vetëm titulli, e në anën tjetër përmbajtja e kërkesës është komplet ndryshe. Në shprehja të interesit nuk vendoset çmimi fillestar. Këto procedura i njoh fort mirë dhe besoj që edhe zyra ligjore duhet ta jep një sqarim.

Kryesuesi: Ne mund të diskutojmë tërë ditën për rendin e ditës, por sinjerisht duhet ta dini që në pikën e 11-të janë pyetjet dhe përgjigjet, për sqarime të thukta, të qarta e serioze. Rendin e ditës e kam lexuar, të cilin po e vendosi në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 14 vota "për" dhe 4 abstenime miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Besoj që procesverbalin e keni lexuar! A ka dikush diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenime?... Me 22 vota pro, miratohet procesverbal.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, P-O-71510057-106-0-2-0, P- O-71510057-106-0-3-0, P- O-71510057-106-0-4-0, P- O-71510057-106-0-8-0, P- O-71510057-106-0-9-0 dhe P- O-71510057-106-0-10-0, ZK-Rahovec:

Altin Zhuniqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë! Të nderuar anëtarë të kuvendit, para jush e keni propozimin lidhur me lokalet e palestrës që janë dhënë në shfrytëzim afatshkurtër. Bëhet fjalë për 6 lokale dhe 3 prej tyre janë: Casa, Fole dhe Bon bon, të cilëve u skadon kontrata në fund të muajit maj dhe 3 lokale tjera janë te pjesa përballë sheshit që janë ende të pashfrytëzuara. Lokali i parë 106-0-2-0, 58 m². Lokali i dytë 106-0-3-0, 63m². Lokali i tretë 106-0-4-0, 63m². lokali i katërt 106-0-8-0, me sipërfaqe 60m². Lokali i pestë 106-0-9-0, me sipërfaqe 60m² dhe lokali i gjashtë 106-0-10-0, me sipërfaqe 60m². Afati kohor i dhënies në shfrytëzim është afatshkurtër dhe është 8 vjet.

Defrim Kafexhiu: Edhe në diskutimet që i kemi pasur në KPF, propozoj në emër të grupit të LVV-së, që këto dy pika të rendit të ditës për dhënie në shfrytëzim të këtyre 6 lokaleve të pezullohen. Lokalet të mos jepen në shfrytëzim derisa kuvendit të merr vendim për hartimin e një rregulloreje për sheshin qëndror të qytetit. Nuk ka institucion privat ose publik kudo nëpër vende të ndryshme, që e trajton pronën në shesh qëndror të qytetit, baraz me një pronë në periferi të qytetit. Është e paarsyeshme që çmimi i qirasë pranë sheshit qëndror të jetë i barabartë me pronat në periferi. Nëse koalicioni qeverisës është kundër, atëherë unë po e ftoj LDK-në që bashkë ta fillojmë një nismë, për hartimin e një rregulloreje. Procedura për hartimin e rregullores mund të shkojë deri në 5 muaj, por është më mirë që si komunë t'i humbim 5 muaj dhe më pas ta kemi një rregullore që e trajton sheshin qëndror ashtu siç duhet. Sa për informatë, qiraja në hapësirat e sheshit qëndror (lokale) janë as 300€. E dimë që është çmimi fillestar, por përsëri është i paarsyeshëm. Nëse nuk ka konkurrencë në ankand, mund jepet çmimi minimal 4euro m². Prona e komunës nuk po trajtohet me dinjitet dhe besoj që është gabim. Në rregull është afati kohor për 8 vite, për shkak të sigurisë së investimit. Drejtor, unë të ftoj ty që të ma japësh një shembull, se si është e mundur që pronat të trajtohen njëjtë si në shesh qëndror si në periferi, ose në ndonjë fshat. Është një problem tjetër: Unë e di që ka njerëz që aktualisht i kanë në shfrytëzim ato lokale te palestra dhe ky diskutim mund të jetë i pakënaqshëm për ata. Besoj gjithashtu që edhe ata do të jetë të mirëkuptueshëm, sepse nuk ka pronë private përreth sheshit qëndror që mund të merret me qira me atë çmim që e jep komuna. Përveç kësaj, rregullorja që po e propozoj sot, do ta specifikojë edhe shfrytëzimin e terraces. Nuk mund një terrace, po e zëmë lokali lart te Rrasat “Erson Baba”, i cili e shfrytëzon terracën, ta paguajë të njëjtën kosto të qirasë sikurse dikush që e merr një terracë në sheshin qëndror. Nëse ju mendoni që kjo është e arsyeshme, atëherë mund të vazhdoni, por ka edhe forma të tjera të kundërshtimit. Edhe pse e keni shumicën e votave, nuk është mire të merrni vendime në dëm të qytetarëve të komunës së Rahovecit.

Feriz Thaqi: Përshëndetje për kryesuesin, drejtorët, anëtarët e kuvendit. E dëgjova Defrimin duke thënë se çmimet janë shumë të ulëta, para një muaj e ka dëgjuar që për parkun thoshte që qiraja është shumë e lartë. Dua ta di, a janë të larta a të ulëta qiratë? Në seancën e fundit e keni përmendur shumë 800€ dhe keni thënë që është tepër për një lokal.

Lirigzon Kastrati: Për këto lokale kam kërkuar informatë dhe shpresoj që drejtori do ta paraqet.

Enis Durguti: Do të thotë për lokalet e palestrës hapet ankand dhe nuk do të bëhet vazhdimi i kontratave për ata që janë aktualisht duke e shfrytëzuar dhe çmimi caktohet nga interesimi i atyre që aplikojnë.

Altin Zhuniqi: Ne e kemi bërë një dëgjim publik për rregulloren për taksa komunale dhe asnjëheri nuk keni marrë pjesë. Çmimi te lokalet e palestrës shkon deri në 655-670 dhe nuk ka lokal me qira që është 300€ te palestra. Sa i

përket lokaleve: Fole, Bon Bon dhe Casa, të trijat dalin në ankand dhe pronarët aktualë janë të barabartë me aplikuesit e tjerë.

Lirigon Kastrati: Meqë erdhi një kërkesë nga shefi i grupit të LVV-së në lidhje me rregulloren. E kuptoj kërkesën, mirëpo ato lokale janë në shfrytëzim dhe nuk mundemi t'ju bëjmë pengesa ligjore derisa ne t'i rregullojmë punët tona. Ne jemi “për” që këto lokale të jepen në shfrytëzim me rregulloren e re që sot votohet, me çmim tjetër.

Kryesuesi: Defrim Kafexhiu e ka bërë një propozim: Të përpilohet një rregullore e re që do t'i trajtojë lokalet e sheshit dhe vetë sheshin. Nëse eventualisht shkojmë kështu dhe meqenëse disa lokale janë në ankand, pyetja është se çka do të bëjmë kur iu skadon kontrata?! Ashtu siç e tha edhe Defrimimi, propozimi për suspendim të pikës së dytë po e vendosi në votim.

Defrim Kafexhiu: Rregullorja e re po miratohet sot dhe duhet ta presim edhe plotëfuqinë nga MAPL. Nuk mund të aplikojmë me rregullore të re, sepse rregullorja e re ende nuk është aprovuar. Në preambulë të vendimit e keni “sipas rregullores së vjetër”. Do të thotë, rregullorja e re nuk mund të aplikohet, sepse ende nuk është miratuar nga ministria. Përkundër që kemi mendime të ndryshme politike, propozimi im për një rregullore të re për sheshin është alternativa më e mirë në interes të qytetarëve dhe është normale që ju si ekzekutiv ta mbron propozimin e juaj.

Kryesuesi: Faleminderit! Mos m'u drejto me “ju”, sepse unë nuk jam në ekzekutiv. Unë jam siç je ti dhe 26 të tjerë.

Isak Hoti: Faleminderit, kryesues! Përsëritet për të gjithë! Nuk është ndryshim kompet i rregullores, është plotësim-ndryshim i rregullores. Nëse ne i dërgojmë dy dokumente paralel në MAPL, vendimin për dhënien në shfrytëzim, si dhe plotësim-ndryshimin e rregullores, atëherë këto dy akte do të na kthehen të njëjtën kohë sipas afatit ligjor dhe tutje ankandi del me plotësim-ndryshimin e rregullores. Do të thotë që kemi kohë të mjaftueshme.

Kryesuesi: Faleminderit! Atëherë, propozimin e Defrimimit për heqjen e pikës së dytë dhe njëkohësisht edhe pikës së tretë, po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 3 vota “për” dhe 14 kundër, propozimi nuk miratohet. Si sugjerim për herave të tjera, këto gjëra duhet të diskutohet para votimit të rendit të ditës. Nëse nuk ka diskutues të tjerë, pikën e dytë po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 22 vota “për” dhe 3 kundër, miratohet pika e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P- O-71510057-106-0-2-0, P- O-71510057-106-0-3-0, P- O-71510057-106-0-4-0, P- O-71510057-106-0-8-0, P- O-71510057-106-0-9-0 dhe P- O-71510057-106-0-10-0, ZK-Rahovec:

Altin Zhuniqi: Propozimi ka të bëjë me pikën paraprake. Kërkohet formimi i komisionit për zbatimin e procedurave, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, 2 prej tyre nga ekzekutivi, 2 nga kuvendi dhe 1 nga sektori joqeveritar.

Kryesuesi: Kërkoj nga përfaqësuesit e grupeve politike, që t'i japin propozimet e tyre.

Saranda Sallteku: AAK, e propozojmë Berat Durakun!

Nehar Shala: LDK, e propozojmë Lirigzon Kastratin!

Vlora Vuçiterna – Çmega: LVV, nuk kemi propozim!

Melinda Oruqi Iska: PDK, e propozojmë Flutura Thaqin!

Kryesuesi: Atëherë, meqenëse i kemi 3 propozime, duhet t'i vendosim në votim një nga një. Kush është për Berat Durakun?... Kundër?... Abstenim?... Kush është për Lirigzon Kastratin?... Kundër?... Abstenim?... Kush është për Flutura Thaqin?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, Berat Duraku 16 vota “për”, Lirigzon Kastrati 8 vota “për” dhe Flutura Thaqi 15 vota “për”. Nga kuvendi në këtë komision janë: Berat Duraku (AAK) dhe Flutura Thaqi (PDK). Meqenëse nuk e kemi as nënkryetarin këtu, e autorizojmë kryetarin për dy propozime nga ekzekutivi për këtë komision, si dhe nga përfaqësuesi i sektorit joqeveritar. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 12 vota “për”, miratohet pika e tretë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i raportit financiar janar-mars 2026:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, drejtorë, të nderuar nxënës dhe ju asambleistë. Kam kënaqësinë që para jush ta lexoj raportin financiar 3-mujor janar-mars, i cili, për dallim prej raporteve të tjera është më i shkurtër dhe përbëhet nga dy pjesë: pjesa e të hyrave dhe pjesa e shpenzimit të buxhetit. Në raport mungon pjesa e kontratave të lidhura, sepse deri në këtë periudhë nuk kemi ndonjë kontratë të lidhur. Besoj që në raportin 6-mujor do të ketë kontrata të lidhura, gjithashtu obligime financiare dhe kontraktuale. Të hyrat, në total për këtë periudhë janë: 272.258 dhe nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, atëherë kemi një rezultat negativ prej 57.955. E kemi edhe një tabelar tjetër, ku bëhet një krahasim i të hyrave ndërvite, duke filluar nga viti 2020-2026 dhe shihet që viti 2026 është shumë më i ulët në krahasim me vitet e tjera. Kjo gjendje kryesisht është kështu, sepse faturat e tatimit në pronë janë procesuar në fillim të muajit prill dhe në periudhën aktuale procesi po shkon shumë mirë. Në faqen nr. 4 janë të hyrat e rregullta, bashkë me gjobat e gjykatave dhe të trafikut, këto të fundit nuk i kemi në raport se sa kanë qenë për këtë 3-mujor. Rezultati në krahasim me vitin e kaluar është minus 149.000. Ka ardhur edhe raporti i gjobave të gjykatave dhe të trafikut dhe për këtë periudhë 3-mujore në total janë 120.000. Nëse i mbledhim të hyrat e rregullta, bashkë me gjobat e gjykatave dhe të trafikut, atëherë bëhen 392.000. Në faqen nr. 7 e kemi shpenzimin e buxhetit sipas kategorive ekonomike, duke u bazuar në programet aktuale. Atëherë, përqindja e shpenzimit të buxhetit është 36.98%. Sa për për dijeninë tuaj, te investimet kapitale është 57.52% dhe realisht nuk e kemi ekzekutuar asnjë cent, të gjitha këto janë mjete të tërhequra nga thesari, duke e zbatuar kontratën kolektive në arsim. Pra, 2.846.000€ janë tërhequr vetëm te pjesa e investimeve kapitale. Sipas kërkesë së Lirigzonit ju informoj që, deri më tani në total nga thesari për kontratën kolektive dhe një pjesë nga përmbaruesit për operatorët ekonomikë, janë tërhequr 2.910.000€. Vetëm për kontratën kolektive janë 2.124.000 dhe për operatorët 726.000 dhe nga përfituesit e tjerë janë 58.000. Para dy dite janë tërhequr edhe 270.000 dhe atë kryesisht në kategorinë mallra dhe shërbime.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit për informatën, drejtor! Në KPF e diskutuam që të informata të jetë me dallim të vitit parapak 2025 me muajt janar, shkurt dhe mars 2026, por në rregull. Te çështja e mallrave dhe shërbimeve sipas kodeve ekonomike. Drejtor, këto që i the janë shpenzimet që janë bërë për tre muaj, ndërsa për vitin 2025 është për komplet vitin kalendarik (faqja 13). Tani, për 3 muaj, transporti për udhëtime të zyrtarëve brenda vendit janë shpenzuar 859.000, kurse për komplet vitin kalendarik 2025 janë shpenzuar 1.338.000€. Është mirë të na njoftoni më shumë rreth këtyre shpenzimeve. Te kontrata kolektive edhe në vitin e kaluar e kam marrë në përgjigje. Në vitin e kaluar, në seancën e muajit gusht 2025, keni folur kështu: Deri në muajin gusht, për kontratën kolektive janë tërhequr 2.120.000€. Tërheqja për zbatimin e kontratës kolektive ka filluar nga viti 2021 dhe vlera ka qenë 8268€. Në vitin 2022 ka qenë 173.000€. Në vitin 2023, 815.000€. Në vitin 2024, 1.600.000 dhe deri në gusht të vitit 2025 i bie të jenë tërhequr 2.120.000€. Sipas këtij raporti keni deklaruar për kontratë kolektive obligimet janë 5.848.000, kurse janë paguar 4.666.000 dhe në përgjigjen e ofruar në gusht të vitit 2025, keni deklaruar se kanë mbetur edhe 1.110.000, kurse tani the që, shpenzimet përmbarimore gjithsej janë 2.910.000, kurse për kontratë kolektive janë 2.124.000. Në raportin e gushtit 2025 keni deklaruar që edhe 1.110.000, kurse tani 2.124.000? Drejtor, edhe sa kanë mbetur saktë? Dua ta di nëse zyra ligjore e ka ndonjë raport rreth menaxhimit të situatës për kontratën kolektive? A ka evidencë? Sa lëndë janë paraqitur? Sa përgjigje në padi janë pranuar nga zyra ligjore?

Fahrije Lushi: Faleminderit i nderuar kryesues! I nderuar nënkryetar, të nderuar këshilltarë. Dëshiroj ta plotësoj pak drejtorin, te realizimi i të hyrave vetanake për 3-mujorin 2026. Drejtori e përmendi veç realizimin, ndërsa planifikimin jo, sepse është një shifër me diskrepancë të madhe. Të planifikuara janë 562.853, ndërsa realizim kemi 272.285. Është diçka që njëmend ta tërheq vëmendjen, te planifikimi 2026 për këtë 3-mujor i kemi shifrat blanko. Shuma 157.617.53 është për tre muaj rresht. Pse po na përsëritet kjo dukuri, pothuajse secilin herë? Kur vjen koha për auditim kombëtar, gjithmonë kemi rekomandime dhe keqklasifikime. E njëjta gjë është edhe te tatimi në pronë. I keni planifikuar 64.952.67 dhe përsëri keni shkuar në të njëjtën metodë që t'i planifikoni të hyrat nga tatimi në pronë.

I keni planifikuar 194.858, ndërsa keni arritur t'i realizoni vetëm 72.148. I dimë të gjitha procedurat, sepse jemi asambleistë për të tretën herë, mirëpo nga drejtori e dua një sqarim më dinjitoz.

Afrim Limani: Lirigzon, dallimi i shpenzimit 2025 me 2026 është gjendje reale. Këtu ndoshta është dallimi prej 500.000€, sepse varet prej kryerjes së pagesave. Supozojmë që, një fatur ka qenë në vlerë 500.000 dhe ajo e ka rritur vlerën. Në këtë vit e di që kemi kryer shumë pagesa në Drejtorinë e Arsimit. Te kontrata kolektive: Është e vërtetë që e kam prezantuar edhe më parë dhe sipas shënimeve tona që i kemi pasur e kemi ditur që kjo vlerë është kaq, mirëpo deri në fund të vitit e kemi paguar edhe një sasi tjetër dhe sot nuk e dimë saktë se sa është vlera totale e kontratës kolektive, sepse është e pamundur që ne t'i kemi ato të dhëna. Konsideroj që, me këtë e kemi përfunduar, mirëpo kanë filluar të vinë disa lëndë nga apeli dhe këtu vlera kalon 200.000€. Fahrija i bëri disa pyetje, dallimi në mes planifikimit dhe realizimit: Planifikimin total që e kemi, e kemi përpjesëtuar për muaj dhe kemi ardhur në përfundim kështu. Të dhënat janë të prezantuara për tre muaj dhe realizimin e keni në faqen tjetër. E thash në fillim, sivjet ka dallim të madh në mes planifikimit dhe realizimit dhe kryesisht në tatimin në pronë, sepse këto tre muaj tatimin në pronë e kanë paguar vetëm ata që kanë pasur vullnet dhe pikërisht ky është dallimi.

Lirigzon Kastrati: Drejtor, a ka mundësi që zyra ligjore të na njoftojë që nga viti 2021 sa lëndë i ka pranuar për kontratën kolektive? Të na njoftojë se sa janë shpenzime përmbartimore në kuadër të kontratës kolektive dhe sa janë paguar për kontratën kolektive?

Afrim Limani: Po, zyra ligjore bashkë me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa i ka këto shënime dhe në seancën e radhës mund t'ju tregoj. Sa për kuriozitet, Asociacioni i Komunave ka bërë padi në gjykatë për këtë padrejtësi rreth kontratës kolektive dhe shumë shpejt presim një verdikt pozitiv në dobi të komunave.

Kryesuesi: Faleminderit, drejtor! Raportet nuk votohen në kuvend. E kam një propozim për pauzë dhe nëse jeni dakord shihemi në orën 13:00.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për Taksa Komunale:

Altin Zhuniqi: Drejtoria për Ekonomi, si iniciuese për ndryshim-plotësimin e rregullores për Taksa Komunale e ka për qëllim prurjen e investitorëve në komunën e Rahovecit dhe ju lexoj propozimet e bëra: Pronat komunale që gjenden në rrugën magjistrale, qiraja ka qenë 0.20 centë, propozimi është 0,05centë. Çmimi i qirasë mujore për zonën e dytë që përfshin pronat komunale në periferi, qiraja ka qenë 0.10, propozimi është 0.03 centë. Çmimi i qirasë mujore për zonën e tretë që përfshin pronat komunale kodrinoro-malore, qiraja ka qenë 0.5 centë, propozimi është 0.01 cent. Te çmimi i qirasë mujore për zonën e parë, për ndërtime të objekteve të përkohshme, çmimi ka qenë 0.50 centë, propozimi është 0.10 centë. Në zonën e dytë ka qenë 0.30 centë, propozimi është 0.05 centë dhe në zonën e tretë ka qenë 0.20 centë dhe tani është 0.02 centë. Plotësim-ndryshim kanë bërë edhe drejtoritë e tjera dhe për gjitha pyetjet si ekzekutiv jemi këtu.

Yllka Shehu: Faleminderit, kryesues! Te materiali i rregullores, te kapitulli 3, lidhur me lartësinë e pagesës së taksës për certifikata dhe dokumente zyrtare, kam vërejtur rritje të trefishtë. Pyetja ime: Pse është bërë kjo rritje e trefishtë dhe pse mos të bëhet një rritje graduale?

Defrim Kafexhiu: Pse po bëhet ky plotësim-ndryshim i rregullores, apo është hartim i rregullores së re? Plotësim-ndryshimi, a ka ardhur për shkak të kërkesave të qytetarëve, apo sipas kërkesës së drejtorisë për shkak të çmimeve të larta, sepse po e shohim që te çmimet e qirasë ka rënie drastike? Tjetra, si mbetet puna me ato prona që tanimë janë në shfrytëzim, sepse ka prona që janë të nënshkruara me çmime të vjetra? A ndryshohen këto kontrata, apo ata vazhdojnë deri në afatin që e kanë, me çmime të pandryshuara?

Lirigzon Kastrati: P.sh.: te drejtoria e Administratës kemi ndryshime të vlerës së taksës, ndërsa te drejtoria e Shëndetësisë nuk po shoh ndryshime, a janë çmimet këto që kanë qenë, apo janë ndryshuar? Nëse ka mundësi një aryetim nga drejtori për shërbimet hoteliere, e pashë që keni bërë zvogëlim të taksës.

Kryesuesi: Faleminderit! Dikush tjetër? Nëse jo, unë e kam një pyetje! Te faqja nr. 27 pika 3 (me të kuqe), diskutim-leje për vendosjen në objekte të përkohshme, në objekte private, vendosja e tavolinave – karrikave dhe ekspozimi i mallit. Nëse nuk diskutojmë, çka bëhet?

Altin Zhuniqi: Defrim, arsyeja e plotësim-ndryshimit është dy kontratat e kësaj natyre: njëra është e Eurobeg dhe tjetra një lokal në Zaqishtë. Kontrata e Eurobeg-ut është dërguar në përmbartues, sepse i ka mbi 7000 euro borxh dhe ajo tjetra vazhdon me kontratën e vjetër, sepse edhe 3 vjet i skadon. Gjithashtu, kemi pasur kërkesa nga investitorët për t'i zbritur çmimet, sepse për m² çmimi ka qenë shumë i lartë. Lirigzon, te pyetja për sallat e dasmave: e kam bërë me qëllim propozimin prej 600 në 500 në muaj, sepse ata zakonisht i kanë marrë për 1, 2, ose 3 ditë.

Afrim Dina: Faleminderit, kryesues! Të nderuar kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit. E pata një pyetje nga zonja Shehu rreth kapitullit 3. Ne kemi propozuar që t'i kemi disa ndryshime të vogla. Te pika 8: certifikatat e bashkësisë familjare kanë qenë 2€ dhe i kemi bërë 3€. Deklarata për mbajtës të familjes, deklarata kjo që kërkohet një herë në vit nga ata që janë në mërgim, të cilët deklarojnë që e ndihmojnë familjen e tyre me 500€ në muaj, para këto që ua kthen shteti ku jetojnë në fund të vitit. Propozimi për këtë deklarata nga 10 euro është në 15. Te kurorëzimi jashtë objekteve të komunës dhe jashtë orarit të punës nga 50€ kemi propozuar të jetë 70. Këto janë disa nga ndryshimet e propozuara nga drejtorja e Administratës.

Isak Hoti: Lirigzon, çështja e taksave në drejtorinë e Shëndetësisë është e përcaktuar me udhëzim administrativ dhe aty nuk mund të kemi ndërhyrje.

Yllka Shehu: Realisht, unë e pata pyetjen për kategoritë që kanë ndryshuar në mënyrë të trefishtë: Vërtetimi për afërsinë familjare, vërtetimi mbi marrëdhëniet familjare dhe pika 14. vërtetimi që personi është në jetë.

Afrim Dina: Këto janë vërtetime që kërkohen më rrallë, pothuajse një herë në vit. Kjo rregullore është që ka viti 2020 dhe për 6 vite kemi shumë lëvizje në shpenzime të tjera.

Kryesuesi: Nëse nuk ka diskutues të tjerë, po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 22 “për” dhe 4 abstenime, miratohet pika e pestë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt-rregullores për Procedurat dhe Kriteret e Ndërtimit në Komunën e Rahovecit:

Jetmir Ukaj: Përshëndeje! Për ata që nuk më njohin, jam Jetmir Ukaj – zyrtar në drejtorinë e Urbanizmit. Kjo pikë e rendit të ditës paraqet një përditësim të rregullores dhe nuk është rregullore e re. Ky përditësim ka qenë i domosdoshëm për shkak të ndryshimeve në ligj dhe në udhëzimet administrative. Rregullorja ka për detyrë që të sjellë qartësi, duke i përcaktuar saktë kriteret e ndërtimit dhe rrit transparencën në procesin e ndërtimit. Gjatë fazës së konsultimit publik kemi qenë të hapur për komente, të cilat janë trajtuar dhe është reflektuar aty ku ka qenë e arsyeshme.

Lirigzon Kastrati: Dëshiroj që paraprakisht ta diskutoj me drejtorin, që në emër të grupit ta bëj një propozim. E kemi diskutuar me ekspertë të fushave: Te neni 16, distanca e gabaritit bazë, ka të bëjë me zonën urbane të qytetit, kurse neni 24 largësia për ndërtim te parcela është 300 cm. Kërkoj që e njëjta të specifikohet te neni 24.8 dhe ta bëjmë me kufizim për hapjen e dritareve, por vetëm me ndriçim sekondar.

Defrim Kafexhiu: Edhe këtu, njëjti sikurse te plotësim-ndryshimi i rregullores për taksa komunale është mirë të dimë, nëse po bëhet me motiv për harmonizimin e ligjeve në fuqi. Pse po bëhet ky plotësim-ndryshim, përderisa si komunë po e presim Hartën Zonale? Çka i duhet kjo rregullore komunës? Si anëtarë të kuvendit, besoj që është dashur t'i kemi edhe nenet me të cilat kjo rregulloren po harmonizohet. Çka ka pasur “mangu” komuna e Rahovecit që tani po e bëjmë këtë rregullore dhe në momentin kur të vjen Harta Zonale, kjo rregullore a do të jetë e zbatueshme?

Albnor Mullabazi: Faleminderit, kryesues! Defrim, kjo rregullore është dashur të plotësohet për shkak të harmonizimit me ligjin ekzistues të ndërtimit. Më shumë se 1 vjet jemi duke e pritur Hartën Zonale dhe ende nuk e kemi një përgjigje të qartë nga ministria. Nuk mund ta lëmë këtë rregullore pa e plotësuar, sepse Harta Zonale nuk e dimë se kur vjen, meqë kjo nuk varet prej neve. Kjo është arsyeja e kësaj rregulloreje, në mënyrë që njerëzve t'ju

lëshojmë leje për kushte ndërtimore në bazë të ligjit për ndërtim. Në moment që vjen Harta Zonale, hyn në fuqi dhe e vazhdojmë punën me Hartë Zonale. Meqë partia e juaj është në pushtet, ju lus që t'i bëni pak presion ministrisë përkatëse. Pjesa e gabëritit është e përcaktuar në bazë të ligjit në fuqi. Nuk mund të hapet dritarja nën distance 3m nga fqinji, pa pëlqim paraprak nga ai. Në moment që e merr pëlqimin, mund t'i ofroresh deri te vija (mexha) e parcelës. Kjo rregullore na duhet për specifika teknike rreth lejeve dhe kushteve të ndërtimit, gjithmonë duke u bazuar në ligj.

Lirigzon Kastrati: Pika 24.7 distanca në mes objekteve ndërtimore në fshatra mund të jetë edhe zero cm, nëse arrihet marrëveshje me shkrim mes fqinjësh dhe të vërtetohet te noteri. Unë kërkoj që deri në një metër të jetë e arsyeshme. Propozimi im është pas konsultimit me ekspertë të fushave, duke mos i maltretuar qytetarët për marrëveshje noteriale.

Jetmir Ukaj: Ajo që ceket te neni 16 është distanca nga vija e parcelës, ndërsa te neni 24.5 është e cekur distanca e objektit individual banimor nga objekti ekonomik dhe objekte e tjera ndihmëse duhet të jetë minimumi 1000cm. Jemi duke e pritur edhe Hartën Zonale, e cila do t'i definojë më specifikisht këto çështje dhe besoj që me aprovimin e Hartës Zonale kjo rregullore bie poshtë.

Jusuf Dërmala: Te neni 23.4 për trojet e ndërtimit të objekteve të banimit kolektiv dhe afarizëm, sipërfaqja minimale 10 ari dhe duhet të ketë dalje frontale në rrugë 15m. Dua të ndërlihem në atë se sa objekte janë në ndërtim dhe sa leje janë lëshuar pa këtë kriter 10 ari? Ne, sot e kësaj dite po shohim ndoshta edhe 5, 6 apo edhe 7 ari. Tani kjo rregullore po hyn në fuqi, a ka qenë edhe më herët ky kriter?

Defrim Kafexhiu: E këqyra, Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe ligjin për Ndërtim L 104/10 më duket, nuk kanë pasur asnjë ndryshim kaq shpejt, sepse e the që po e harmonizojmë rregulloren me ligjet në fuqi. Këtë plotësim-ndryshim po e bëni për arsye të tjera dhe jo për harmonizim me ligjet. Këto dy ligjet që janë në preambulë nuk kanë pasur plotësim-ndryshim. Njëri është nga 2013 dhe tjetri 2011. Tjetra, nëse po e bëni këtë rregullore që të kryeni punë, ende pa ardhur Harta Zonale, pse nuk e keni bërë para 1,2,3 apo 4 viteve? Nëse nuk keni mundur të bëni zgjidhje pa Hartë Zonale, pse atëherë nuk i keni lënë investitorët të investojnë dhe t'ia përshtatni këtë rregullore më herët? Nëse kemi pritur deri tash për Hartën Zonale, pse mos të presim edhe pak? Vetë e the që LVV është në pushtet, por nuk mund të kërkosh aprovim të Hartës Zonale, kur në fakt e keni dërguar me gabime, ose nuk e keni kompletuar sipas kritereve që kërkohen. E ftoj dikë nga zyra ligjore që të na argumentojë këtë pjesë. Pse nuk e keni përshtatur këtë rregullore më herët dhe a është ligjërish në rregull ky plotësim-ndryshim i rregullures, si dhe a do të lejohet ndërtimi vetëm në bazë të kësaj rregulloreje, pa Hartë Zonale?

Albnor Mullabazi: Defrim, kushtet dhe lejet ndërtimore lëshohen në bazë të ligjit ndërtimor dhe udhëzimeve, ndërsa rregullorja i plotëson distancat që janë brenda. Kushtet edhe lejet i lëshojmë në bazë të ligjit të ndërtimit. Rregullorja e kaluar ka qenë e vitit 2006 dhe pikërisht për këtë po bëhet edhe plotësim-ndryshimi. Vitin e kaluar nuk e kemi bërë këtë rregullore, sepse e kemi pritur miratimin e Hartës Zonale. Pesë herë e kemi dorëzuar Hartën Zonale, me pesë komentet nga ministria dhe kanë kaluar më shumë se një vit dhe ende jemi në pritje. Në komentin e parë të ministrisë është kërkuar që ta heqim Hoçën, në komentin e dytë për zonën ekonomike që nuk është me plan hapësinor, duke e ditur që Plani Hapësinor i Kosovës është bërë në 2010, ndërsa pëlqimi nga ministria për zonën ekonomike është bërë në 2017 dhe në të njëjtën kohë një vendim që është marrë në 2017 nuk mund të jetë me një dokument që është planifikuar në 2010. Këtë rregullore po e plotësojmë dhe ndryshojmë pas 20 viteve, sepse rregullorja ekzistuese ka qenë e vitit 2006.

Defrim Kafexhiu: Sipas ligjit për ndërtim, ju nuk keni mundur të lëshoni kushte ndërtimore. Kemi pasur diskutime në këtë kuvend për raste specifike, me arsyetimin që është në fuqi PZhK-ja dhe duhet ta presim Hartën Zonale, sepse kemi mbetur në një vakum që për moment nuk kemi mundësi për zgjidhje. Nëse kjo rregullore tani të lejon që të bazohesh në Ligjin për Ndërtim dhe t'i lëshosh kushtet ndërtimore, pse nuk e keni bërë më herët, para 2,3, apo 4 viteve? Tani, me këtë rregullore, a është e mundur që drejtorie e Urbanizmit të lëshojë kushte dhe leje ndërtimore për investitorët që presin për investim, ende pa u miratuar Harta Zonale?

Albnor Mullabazi: Defrim, drejtorja për Urbanizëm do të vazhdojë të lëshojë kushte dhe leje ndërtimore. Nuk mund të lëshojmë kushte dhe leje ndërtimore për etazhitet më të madhe se në rreze 50m. Sot në Rahovec mund të bëhet ndërtimi P+6, por vetëm në rreze 50m dhe ka vende të caktuara me P+7. Gjithashtu, vazhdojmë të lëshojmë leje ndërtimore duke u bazuar në PZhK. Askush në drejtori të Urbanizmit nuk punon në bazë të tekeve dhe dëshirave, punojmë vetëm duke u bazuar në ligjet në fuqi. Jemi sprovuar edhe në hetuesi, me mbi 80 lëndë, por sot e kësaj dite, duke punuar drejt, asnjë zyrtar i urbanizmit dhe as unë si drejtor nuk kemi aktakuzë.

Kryesuesi: A ka diskutues të tjerë? Nëse jo, po e vendosi në votim projekt-rregulloren. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 23 vota “për” dhe 2 abstenime, miratohet pika e gjashtë.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin, përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shërbime Publike:

Kryesuesi: Formimi i komiteteve ka qenë kërkesë e të gjithë neve dhe sot i kemi dy formime të komiteteve joobligative. Lirigzoni si propozues nëse eventualisht ka diçka për të thënë?

Vlora Vuçiterna – Çmega: Përveç këtyre komiteteve, në seancat e ardhshme a do të formohen edhe komitete të tjera. P.sh.: Pse mos të formohet edhe Komiteti i Arsimit, i cili në mandatin e kaluar nuk ka qenë funksional.

Kryesuesi: Në këtë seancë i kemi vetëm 2 dhe tutje e shikojmë, është mirë t’i formojmë.

Lirigzon Kastrati: Kur e kemi diskutuar projekt-planin e kuvendit komunal, kemi dhënë propozime dhe një ndër propozimet e mia ka qenë edhe formimi i Komitetit për Shërbime Publike, veçanërisht edhe dy komitete të tjera, për shëndetësi dhe arsim, si dhe nga ekzekutivi ka ardhur propozim Komiteti për Emergjencë. E mirëpres këtë vendim.

Kryesuesi: Atëherë, nga secila parti politike kërkoj nga një emër. Sqarim: Nëse një përfaqësues është në një komitet tjetër, i njëjti nuk mund të jetë në dy komitete.

Berat Duraku: AAK, e propozojmë Florida Bajraktarin!

Lirigzon Kastrati: LDK, e propozojmë Enis Durgutin dhe i njëjti nuk është i përfshirë në ndonjë komitet tjetër.

Defrim Kafexhiu: LVV, e propozojmë Bujar Mustafën!

Melinda Oruqi – Iska: PDK, e propozojmë Mirsad Shehun!

Kryesuesi: Ju komunikoj që edhe në fushën e ekspertëve të jashtëm e kemi përsëri të gjinisë mashkullore dhe këtu nuk plotësohet kuota gjinore. Vendimi i tillë kthehet si i kundërligjshëm nga MAPL. Kërkoj nga ju që njërin nga kandidatët e partive politike të ndërrohet dhe të zëvendësohet me gjininë femrore.

Defrim Kafexhiu: Propozoj që vendimi të shkojë kështu dhe ta shikojmë nëse MAPL e kthen ose jo. Do të kemi edhe komitete të reja dhe nuk do të kemi femra të mjaftueshme. Menjëherë e kemi një komitet tjetër dhe përsëri do të jetë problem.

Kryesuesi: Dihet që nga MAPL verdikti është i kundërligjshëm. Komiteti për Komunitete është kthyer pikërisht për shkak të kuotës gjinore. Nga LDK-ja a kemi ndyshim?

Lirigzon Kastrati: Kryesues, Hazbija është e përfshirë në Komitetin për Komunitete dhe nuk kemi propozim tjetër.

Defrim Kafexhiu: LVV po ashtu e ka një femër në një komitet tjetër obligativ dhe një femër tjetër që e kemi, e kemi propozim për komitetin e radhës.

Melinda Oruqi – Iska: PDK-ja nuk e ndërrohet, Mirsad Shehun e kemi edhe pikë.

Kryesuesi: Atëherë, unë i kam emrat, por dijeni që vendimi do të kthehet si i kundërligjshëm.

Defrim Kafexhiu: Mund ta bëjmë një tolerim, që në këtë komitet ta vendosim një femër, por në komitetin e radhës duhet patjetër ta vendosim një mashkull.

Kryesuesi: Meqenëse ne vetë jemi propozues të këtyre komiteteve si kuvend, kërkoj mirëkuptim nga ju. E kam një propozim, këtë pikë të rendit të ditës ta bartim për seancën tjetër. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 15 vota pro dhe 1 kundër, shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për në seancën e radhës.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin, përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Mbrojtje, Shpëtim dhe Emergjencë:

Kryesuesi: Ju lus që të reflektoni dhe nëse eventualisht do ta kemi të njëjtën situatë, përsëri propozimi im është që pika të shtyhet.

Berat Duraku: AAK, e propozojmë Ruzhdi Morinën!

Lirigzon Kastrati: LDK, e propozojmë Nehar Shalën dhe i njëjti nuk është anëtar i asnjë komiteti tjetër.

Defrim Kafexhiu: LVV, për hir të bashkëpunimit të mirëfillt, e propozojmë Zana Qantën!

Melinda Oruqi Iska: PDK, e propozojmë Behlul Krasniqin!

Kryesuesi: Nga ekzekutivi, si ekspert është caktuar Hajriz Morina dhe përsëri kemi problem me koutën gjinore.

Vlora Vuçiterna – Çmega: A është mundësia që të ndërrohet eksperti i jashtëm dhe të vendoset femër?

Kryesuesi: Eksperti veçse është caktuar nga ekzekutivi dhe kërkoj reflektim nga ju.

Berat Duraku: Atëherë, për shkak të kësaj situatë, e tërheqim Ruzhdi Morinën dhe e vendosim Dafina Gashin.

Dafina Gashi: Faleminderit, kryesues! Flaminderit, shef i grupit! Propozoj që këtë pikë ta shtyejmë për seancën tjetër!

Kryesuesi: Faleminderit! E kemi propozimin e Dafinës, që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës. Kush është “për”?... Kundër?... Me 12 vota “për”, pika e tetë e rendit të ditës shtyhet për seancën e radhës.

9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për miratimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të këshillit të fshatit

Hoçë e Madhe:

Senad Mullaavda: Përshëndetje kryesues, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të kuvendit. Sa i përket kësaj pike, më lejoni t’ju njoftoj se, ad hoc komisioni i emëruar me vendim të kuvendit i ka ftuar anëtarët e komisionit që të marrin pjesë në takim, i cili është mbajtur më datë 8 prill. Takimi është mbajtur, ku ata kanë pasur mundësi t’i shqyrtojnë aplikimet e kandidatëve. Në atë mbledhje janë përzgjedhur pesë kandidatë, tre prej tyre të komunitetit serb dhe dy të komunitetit shqiptar. Anëtarë të përzgjedhur nga komuniteti shqiptar janë: Elvedina Cana dhe Arita Gashi, ndërsa të komunitetit serb janë: Bojan Pavloviq, Milan Petroviq dhe nga kisha ortodokse serbe, Zvezdan Miciq. Të gjitha veprimet e kryera janë të bazuara në Ligjin për Fshatin Hoçë e Madhe, si dhe udhëzimin administrativ për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësitë dhe funksionimin e këshillit të fshatit. Dje, në adresë të sekretarisë kanë arritur dy ankesa nga kandidatët e komunitetit serb, të cilët i kanë ankesat e tyre sa i përket procesit të përzgjedhjes së anëtarëve serb. Për fat të keq, këto kërkesa nuk kanë arritur te ju, për shkak të problemeve që i kemi pasur me rrjet. Për çdo pyetje eventuale jam këtu.

Lirigzon Kastrati: Kush ka qenë kryetari i këtij komisioni? Procesverbalin po e shoh, por nuk ka kryetar të komisionit. Dy anëtarët e caktuar nga kuvendit nuk e paskan nënshkruar procesverbalin dhe votimi është marrë vetëm na komuniteti serb. Kërkoj ta dimë se kush janë aplikantët e tjerë dhe një biografi të shkurtër se kush është Elvedina Cana dhe Arita Gashi?!

Defrim Kafexhiu: Pajtohem me kërkesat e Lirigzonit! Të na informojë dikush se sa aplikantë kanë qenë, cilat kritere i ka shfrytëzuar komisioni dhe besoj që do të ishte më mirë që dikush prej anëtarëve të komisionit nga kuvendi të na informojë?! Përveç biografisë së anëtarëve shqiptarë, si kuvend duhet ta dimë edhe nga një biografi për 2 serbë që i vendosë këshilli lokal i Hoçës së Madhe.

Mentor Veliu: Kërkoj edhe unë biografinë e anëtarëve të komunitetit serb dhe pastaj e diskutojmë.

Isak Hoti: E mora vesh nga Senad Mullaavda që është një ankesë. Ankesa është kundër vendimit të komisionit ad hoc. Neni 8 i udhëzimit thotë: zgjidhen sipas procedurës së ligjit dhe procedurës administrative brenda afateve ligjore dhe konsideroj që kjo pikë e rendit të ditës nuk mund të votohet, përderisa ankesat nuk janë shqyrtuar.

Lirigzon Kastrati: Kryesues, kjo situatë është shqetësuese, sepse ende a u shtjerrur të gjitha mjetet juridike, materialin e kemi në kuvend për procedim.

Kryesuesi: Lirigzon, ne nuk i emërojmë, por vetëm i votojmë! Komisioni e ka bërë përzgjedhjen. E ftoj Senadin për sqarime rreth ankesave, sepse për arsye të këtyre ankesave, kjo pikë e rendit të ditës nuk mund të vendoset në votim sot.

Senad Mullaavda: Ankesa është dorëzuar më datë 24 (të premten) dhe në zyrë ka arritur dje (e hënë). E thash që nuk kemi mundur t'ju procedojmë për shkak të problemeve teknike. Kanë konkurruar 6 kandidatë të komunitetit serb dhe 9 të komunitetit shqiptar. Emrat e dhe biografinë e tyre janë pak sa konfidenciale, sepse këtë çështje komisioni e ka për detyrë. Sa i përket kandidatëve serbë, Petroviq është me profesion mjek-stomatolog dhe Bojan Pavloviq është mjek i mjekësisë së përgjithshme.

Melinda Iska: Nëse ka mundësi, tregojë një biografi edhe për dy kandidatët shqiptarë.

Senad Mullaavda: Biografia është detyrë e ad hoc komisionit, unë ju tregova vetëm profesionet e tyre.

Mentor Veliu: Kryesues, këtu konfidenciale nuk ka asgjë, sepse nuk po e zgjedhim ndonjë inspektor të AKI-së. Ky me mbiemrin Petroviq, duket të jetë i biri i Sergjenat dhe nëse dikujt i kujtohet para disa viteve që na ka bërë "horë", jo vetëm komunën tonë, por komplet Republikën e Kosovës. Të na sevojhet një emër i tillë është turp për këtë kuvend komunal dhe për secilin prej neve.

Isak Hoti: Jorrallë kemi kërkuar nga Ministria e Planifikimit Hapësinor si sponsorizuese e këtij ligji dhe rregullores që e kanë, sinqerisht janë gjëra të paqarta, përfshirë këtu edhe komisionin e ankesave. Komisioni për përzgjedhje votohet në kuvend dhe nuk e kam të qartë, sepse asnjë ligj nuk e precizon se kush e formon komisionin e ankesave. Në qoftëse i kemi dy ankesa, të domosdoshme e kemi ta zgjedhim edhe një komision. Propozoj që, (nuk e di a është i ligjshëm apo jo) të zgjidhet tani një komision për ankesa që t'i shqyrtojë këto ankesa, i përbërë prej 3 anëtarëve të kuvendit. Komisioni të formohet sot.

Kryesuesi: Është situatë pak konfuze, sepse nuk e di nëse kemi të drejtë që si kuvend ta themelojmë këtë lloj komisioni. Nuk e kemi as në rend dite, as në ligj e as në udhëzim administrativ. E autorizojmë zyrën ligjore, nëse komisioni i përhershëm mund t'i trajtojë këto ankesa?! Në bazë të ligjit për fshatin Hoçë e Madhe, komisioni për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit e bën zgjedhjen e aplikantëve dhe ia dërgon kuvendit vetëm për miratim formal. Ju e keni një procesverbal aty, të nënshkruar prej secilit prej anëtarëve. Mendoj që këto ankesa mund t'i shqyrtojë edhe komisioni i përhershëm i ankesave dhe për shkak të kësaj shtate që e kemi, këtë pikë po e shtyejmë për seancën tjetër.

Defrim Kafexhiu: Në mandatin e kaluar, nëse nuk jam gabim e kemi votuar edhe komisionin e ankesave. Zyra ligjore mund ta shikojë nëse duhet të formohet një komision i ankesave dhe ta votojmë në këtë seancë. Sot po e votojmë këtë komision dhe në seancën tjetër ta kemi si pikë të rendit të ditës.

Florida Bajraktari: Nuk e kam të qartë nëse duhet patjetër të merret parasysh ankesa, apo duhet që fillimisht të votohen dhe nëse dikush prej aplikantëve është i pakënaqur, atëherë të bëjë ankesë. Nuk e kam të qartë aryen e ankesës, ndonëse ende nuk janë votuar këta anëtarë. Ne si komision e kemi pasur për detyrë që t'i shqyrtojmë listën e aplikantëve dhe nuk na ka thënë askush që duhet t'i kemi edhe në kuvend biografite, por vetëm emrat si pako.

Kryesuesi: Faleminderit, Floridë! Në këtë sallë i kemi edhe përfaqësuesit e OSBE-së, që na monitorojnë kryesisht në pika të kësaj natyre dhe nëse kanë diçka për të thënë në këtë pikë, atëherë i ftoj për kontribut. Pauzë 5 min...

Të nderuar kolegë, po e vazhdojmë seancën. Në dakordim me shefat e grupeve u dakorduam që, paraprakisht një herë do të shqyrtohen ankesat, të cilat do të shqyrtohen nga komisioni i përhershëm dhe pas përgjigjes së tyre mund ta kemi në kuvend. Kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për seancën e radhës, për shkak të këtyre paqartësive dhe pikërisht për shkak të ankesave të pranuara. Kush është "për"?... Kundër?... Unanimisht miratohet shtyerja e kësaj pike për seancën e radhës.

10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, P- 71510033-00772-10 Z.K. - Xërxë - Gradish - Base Friends LLC:

Kryesuesi: Besmire Bytyqi nuk e di a është prezente?! Nëse jo, vendimin e keni para vetes dhe eventualisht nëse keni diçka rreth kësaj pike? Për shkak të procedurave të thjeshta një herë është kthyer nga MAPL-ja dhe tani janë përmirësuar.

Lirizon Kastrati: Qëndrojmë prapa në të gjitha deklaratimet që i bëra edhe në fillim të seancës dhe këtë vendim nuk e përkrahim!

Kryesuesi: Faleminderit, Lirigzon! Besoj se të gjitha sqarimet janë bërë në debatin që ndodhi para votimit të rendit të ditës.

Defrim Kafexhiu: Meqenëse Lirigzoni u deklarua për formën e votimit. Unë parimisht jam “për” edhe si aëtar i komisionit që kam qenë, por siç e thashë gjatë diskutimit, është e paarsyeshme që kuvendi të merr edhe një herë vendim për këtë pikë të rendit të ditës dhe deklarohem që duhet të votojë kundër për shkak të procedurës.

Isak Hoti: Kryesues, nëse ma jep mundësinë ta sqaroj çështjen e Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, ku përfshihet edhe Rregullorja: Brenda kësaj i kemi 4 procedura - deri në një vit, me iniciativë të kryetarit të komunës, afatshkurtër deri në 15 vjet dhe afatgjatë deri në 99 vjet. Vendimi kur bëhet me negociim me kryetarin, obligativisht vjen në kuvend. Kur është afatgjatë me shprehje të interesit i kemi dy vendime: Vendimi i parë – kuvendi e autorizon kryetarin e komunës dhe i thotë: “Jepe pëlqimin për t’i filluar procedurat e dhënies në shfrytëzim me shprehje të interesit deri 99 vjet”. Vendimi i dytë – aplikojnë 4-5 aplikantë dhe komisioni e ka për detyrë raportin ta bie në kuvend, gjë që nuk ndodh te dhënia në shfrytëzim afarshkurtër. Pra, janë dy vendime, vendimi paraprak dhe vendimi përfundimtar. Do të thotë, atë që e keni votuar në fillim ka qenë vendim paraprak dhe ky tani është vendim përfundimtar për ta dhënë dritën e gjelbërt për nënshkrimin e kontratës. Te çështja se pse është rikthyer në rishqyrtim: Kam pasur kontakte me ata të MAPL-së dhe kemi mundur që ta bëjmë direkt, pa kuvend, sepse çështjet teknike edhe ligji e lejon përmirësimin. Mirëpo, atje janë ndërruar zyrtarët që ende nuk i kanë ra në fije punës.

Defrim Kafexhiu: Krejt është në rregull, mirëpo atë që e tha Isaku, është dashur të evidentohen nga zyra ligjore para se të shkojnë në MAPL. E the që kuvendit e merr si vendim të dytë, kjo do të thotë që: Vendimin e kuvendit e keni dërguar në MAPL pa aprovim të kuvendit, do të thotë që paska bë edhe pa këtë aprovimin e dytë që të dërgohet në MAPL. Tani, detyrimisht është në kuvend, sepse MAPL-ja e ka kthyer.

Isak Hoti: Ky e di që ka qejf të godasë karate, por nuk është ashtu siç e thotë. Raporti i komisionit nuk vjen te zyra ligjore dhe përderisa Defrimi ka qenë pjesë e komisionit, e din shumë mirë që neve nuk na kanë ftuar në momentin kur e kanë përfunduar raportin.

Skender Hamza: Përshëndetje! Defrim, ky vendim në muajin e kaluar ka qenë në kuvend dhe e keni pasur materialin bashkë me raportin. Ju si kuvendarë e keni pasur mundësinë ta evidentoni gabimin në këtë raport dhe të thoni “që raporti edhe vendimi nuk janë në koordinim me njëri-tjetrin”. Ky ka qenë gabim teknik nga komisioni dhe tani është përmirësuar. Vendimi i njëjtë është votuar edhe në muajin e kaluar.

Kryesuesi: Nëse nuk ka diskutuar të tjerë, po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 14 vota “për”, 7 kundër dhe 2 abstenime, miratohet pika e dhjetë.

11. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:

Hazbije Shala: Faleminderit! I nderuar kryesues, anëtarë të kuvendit, drejtorë. Dua të flas rreth dy çështjeve dhe kërkoj përgjegjësi nga ekzekutivi. E para, kërkoj nga drejtori i DKA-së, si dhe nga kryetari i komunës që të dalin në vizitë në shkollën e fshatit “Haki Stërmilli”, në Zoqishtë. Ta shohin gjendjen dhe kushtet e kësaj shkolle, në të cilat zhvillohet mësimi. Gjithashtu, kërkoj që të caktohet një afat kohor konkret, që kushte e kësaj shkolle të përmirësohen. E dyta, në javën e fundit u publikua një skandal në shkollën e mesme në Krushë të Madhe, ku një profesor ka

demonstruar në prani të nxënësve, me armë të ftohta brenda objektit shkollor. Cilat janë masat e ndërmarra nga DKA-ja në lidhje me këtë rast?

Sali Sallteku: Ne kemi bërë pyetje edhe në seancën e kaluar dhe ju lus që fillimisht t'i marrim përgjigjet dhe tutje t'i bëjmë pyetjet tjera.

Kryesuesi: Jam dakord me juve, nëse ka mbetur dikush pa i dhënë përgjigje prej kuvendarëve nga ekzekutivi, nga pyetjet e seancës së kaluar?

Qazim Cana: Përshëndetje, kryesues! Përshëndetje për nënkryetarin, kolegët, drejtorët, stafin e OSBE-së dhe KFOR-it. Dua ta ngris çështjen e infrastrukturës në Rahovec. Janë vërejtur shumë dëmtime të rrugëve ekzistuese, përveç rrugës së re, këto të tjerat janë me mjaft vende për riparime. Ka shumë gropa që ndikojnë në pjesën e komunikacionit. E dyta: Sinjalistika vertikale dhe horizontale, sidomos te rruga për te "Xhelal Hajda-Toni" dhe "Selajdin Mullabazi – Mici". Në këtë pjesë ka vozitje mjaft të shpejtë, që rrezikon nxënësit dhe do të ishte mirë që të bëhen sinjalistikat në rrugë. Te "Isa Boletini" është një dendësi mjaft e madhe dhe nxënësit për pushim të gjatë mbliqen në masë të madhe. Një strategji më afatgjate do të ishte ndërtimi i një nënkalimi, sepse aty ndodhin shumë incidente. Si çështje, dua ta diskutoj edhe rrugën e shkurtë për te varrezat "Jahja Danuza". Me të vërtetë është në gjendje të rëndë dhe është mjaft e frekuentuar. Me mundësi, kjo rrugë është mirë të rregullohet.

Yllka Shehu: Faleminderit, kryesues! E pata propozimin e njëjtë me z. Sallteku, në lidhje me pyetjet e seancës së kaluar, sepse ende nuk i kemi marrë përgjigjet. Një problem që dua ta parashtroj është mungesa e ndriçimit publik në fshatin Celinë, kryesisht në lagjen Mehmedina, që ndriçimi publik ka 3-4 muaj që nuk funksionon.

Mentor Veliu: Faleminderit, kryesues! Kryetari nuk është këtu, mirë që është drejtori i Shërbimeve Publike dhe drejtori Albtor. Dua ta ngris përsëri çështjen e qendrës së qytetit, qendër e cila paraqet vështirësi në qarkullim, si dhe vështirësi për bizneset aty përreth. Ju lus, ashtu siç po i lut Albtorin atje, si vëlla, e këtu si kolegë e si ekzekutiv. E di gjendjen e buxhetit për këtë vit, por ta shikojmë që vitin tjetër ta gjejmë një zgjidhje, sepse është ngulfatur ai vend dhe dhashtë zoti të përfundojë Qendra Inovative dhe në shtëpinë aktuale të kulturës të krijohen parkingje e më shumë hapësira. Gjithashtu, parcelën që e kam përmendur në seancën e kaluar, është vend ideal për një shtëpi për të moshuarit. Është parcelë e mirë, e përshtatshme, është pronë komunale dhe është afër në qytet, ku këmba-këmbës të moshuarit mund të shkojnë aty. Të gjitha këto, në bashkëpunim të ngushtë me ekzekutivin mund të realizohen për vitin tjetër, me theks të veçantë qendra e qytetit.

Lirigzon Kastrati: Nga Drejtoria e Bujqësisë e kam pranuar përgjigjen me shkrim dhe drejtori e ka sqaruar çështjen e rregullimit të rrugës fushore "Zona Operative – Pashtriku" dhe të "Udhës së Madhe". Është e vërtetë që qytetarët nuk kanë pranuar që të intervenohet në atë mënyrë që ka dashur ekipa emergjente, që ju e keni caktuar. Dje, me me vetëiniciativë dhe vetëfinancim të qytetarëve është shtruar me zhavor. Drejtori ka qenë në vizitë dhe e ka parë nga afër vendin, si dhe jemi dakorduar që të bëhet me zhavor. Ekipa emergjente ka deklaruar që nuk kemi zhavor dhe qytetarët në mënyrë urgjente janë detyruar që të intervenojnë. Gjithashtu, drejtori është në dijeni për mbylljen e një rruge tjetër, që sot po i bëj thirrje që nesër të intervenojë në mënyrë urgjente për heqjen e dheut, sepse është rrugë e bllokuar. Te Drejtoria e Arsimit e kam një pyetje: E pashë që ka dalur thirrja për bursat për studentë, por për vitin shkollor 2025-2026? Drejtor, a lejohet të hapet një thirrje e tillë, kur ende nuk ka përfunduar viti shkollor? Sa e di unë, viti shkollor përfundon në muajin qershor, ndërsa thirrja është deri në fund të majit, sipas afatit ligjor të cekur. Te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport: Në dy thirrje keni ndarë subvencione, shumën e kemi parë veç në mënyrë totale. Jeni thirrë në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, po ashtu te Rregullorja e ministrisë 04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit. Drejtor, kërkohet që në seancën e radhës ta bëni një raport për kuvend. Gjithashtu, është mirë që edhe për vitin 2025. Sa është shuma e dhënë e subvencioneve, kush janë ata që kanë marrë subvencione, si dhe a kanë dorëzuar raporte të implementimit?

Behlul Krasniqi: Përshëndetje, kryesues! Një pyetje e kam për drejtorin e shërbimeve publike: Rruga te "Rrasat e Rahovecit" – rruga për Drenoc, aty është e dëmtuar te një kompani e ndërtimit. Çdo vit ka problem, a është arsyeja

se atij po i konvenon, sepse po e shfrytëzon rrugën për krejt atë material ndërtimi? A është kjo arsye pse nuk rregullohet ajo rrugë? Më tutje, rrugës për Drenoc, banorët e kanë vendosur një pengesë pa leje, që duhet ta ndalim shpejtësinë në zero.

Dafina Gashi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Këtë vit në Nagac, organizohet edicioni i 10-të i turneut në futboll të vogël “Habib Gashi”, turne ky, që po mbledh qytetarë të shumë nga të gjitha vendet. Së fundmi, pjesëmarrës në këtë turne ka qenë edhe kryetari, i cili ka premtuar përkrahje të drejtpërdrejtë këtë vit. Fusha sportive nuk është prej më të mirave dhe ky organizim e meriton një fushë të një niveli tjetër. Terreni sportiv ka nevojë për porta te reja dhe shënjim të fushës. Meqenëse kryetari nuk është i pranishëm, pyetja për drejtorin e kulturës: A do të ketë mbështetje financiare nga komuna këtë vit?

Besnik Hoti: Faleminderit, kryesues! E kam një pyetje për drejtorin e Urbanizmit: Meqë punimet kanë përfunduar, pse nuk po lëshohet në përdorim parkingu nëntokësor te sheshi?

Jusuf Dërmala: Dua të ndërlidhem me çështjen e interpretimeve të zyrtarëve të komunës që i kemi këtu dhe më duket që rregullorja e kuvendit e parasheh shumë mirë që vetëm me ftesë të kryesuesit mund t’i interpretojnë çështjet e ndryshme. Për interpretim janë drejtorët, që paraprakisht duhet të konsultohen me zyrtarët. Është shqetësuese, sepse më shumë po flasin zyrtarët sesa vetë asambleistët. Ne i kemi marrë votat, jo zyrtarët.

Kryesuesi: Pajtohem me Jusufin, ju duhet të flisni! Nuk e di për kë je duke aluduar këtu, për cilin zyrtar komunal që e merr fjalën dhe diskuton pa leje?

Jusuf Dërmala: Nuk e thash “pa leje”, por rregullorja e specifikon se në rast nevojë kryesuesi ia jep fjalën, jo kur t’i teket me një ngritje dore të del në foltore.

Kryesuesi: Besoj që rregulloren e keni lexuar dhe kryesuesi i kuvendit e vlerëson se kujti ia jep fjalën e kujt jo. Ndërsa, ju kuvendarët flisni më shumë, sepse votat i keni marrë për këtë arsye.

Melinda Iska: Faleminderit, kryesues! Një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike: Ndoshta është e 10-ta herë që si kërkesë e kam rregullimin e rrugës “Xhafer Nurkasa”, e cila është në gjendje të mjerueshme. Fatkeqësisht, kurrë nuk kam pranuar përgjigje, madje as me shkrim.

Defrim Kafexhiu: Dua t’ju pyes për rrugën 4-korsi, Rahovec-Xërxë. Kur do të kryhen punimet, edhe pse tani janë ndaluar? Kontrata e lidhur për rrugët: Drenoc, Senoc, Pastasel, Polluzhë, kur pritet të fillojnë punimet? Një pyetje e kam për drejtorin e shëndetësisë tani. E kemi pasur një diskutim para 1 viti e gjysmë rreth një kontrate për rregullimin e varrezave të martirëve. Ku ka mbetur procedura, a është bërë ndonjë punë? Më kujtohet që me një seancë më pate thënë: “Hajde bashkë të hënën, me një veturë do të shkojmë dhe t’i shikojmë punimet”. Nuk e di nëse vazhdon të jesh menaxher i asaj kontrate!

Kryesuesi: Nëse drejtorët kanë përgjigje, mund të përgjigjeni. Nëse për momentin jo, kërkoj që për seancën e radhës të përgjigjeni me shkrim.

Albnor Mullabazi: Në pyetjen e asambleistit, Besnik Hoti, rreth parkingut: Punimet mbi 90% kanë përfunduar te parkingu nëntokësor me 90 vendparkingje dhe për arsye të mirëmbajtjes, parkingu ende nuk është lëshuar në përdorim. Shpresojmë që në seancën e radhës të jetë si pikë e rendit të ditës, dhënia me qira e parkingut në fjalë.

Muhamet Morina: Përshëndetje për kryesuesin, nënkryetarin, kolegët drejtorë, asambleistë të respektuar. Përshëndetje zonja Hazbije Shala dhe faleminderit për pyetjet. Pyetja e parë ishte: “Do të ishte mirë ta vizitonit shkollën e Zoqishtit, për ta parë për së afërmi gjendjen e saj fizike”. Unë e kam vizituar këtë shkollë dhe qëndron kjo që ju thoni. Shkolla nuk i plotëson kushtet që të zhvillohet procesi edukativo-arsimor dhe me një fjalë është mizërie, sepse nuk ka kushte fare për mësim. I kam paraqitur zgjidhjet e mia të momentit dhe ata nxënës do të ishte mirë që të barten në fshatin tjetër, me transport të siguruar nga komuna.

Kryesuesi: Drejtor, për transport e vlerësoni ju si drejtori, jo kuvendi. Duhet t’i ndajmë përgjegjësitë.

Muhamet Morina: Unë po i jap përgjigjet dhe do t’i shterrojë deri në fund, sepse për këtë çështje jam këtu. Pra, kjo është ideja ime për atë shkollë. Ndërsa, për çështjen e profesor Kujtim Gashit në Krushë të Madhe, menjëherë të

nesërmit në mëngjes në 8:30 kam qenë në atë shkollë. Drejtorja e shkollës, bashkë me këshillin drejtues kanë marrë masa që këtë çështje ta drejtojnë DKA-së. Ne jemi në proces e sipër të përgatitjes së provave, për ta destinuar këtë çështje në këshillin disiplinor. Lirigzoni rreth konkursit të bursave: Po, e kemi hapur konkursin e bursave dhe këtë e kemi bërë në bashkëpunim me kryetarin e komunës. Këtë vit kemi menduar që më mirë është që ta zvogëlojmë numrin e bursave, por të rritet shuma e përfituesëve. Meqë në komunën tonë kemi deficit të kuadrove të matematikës, i kam propozuar kryetarit që shuma prej 450€ që ka qenë për një student të matematikës, këtë vit të bëhet 900€ për 9 muaj. Gjithashtu, te studenten me notë mesatare 10.00, duke i parë dosjet e vitit të kaluar, kam vërejtur që ka pasur studentë që sapo e ka regjistruar fakultetin dhe me vetëm një notë (10) ka thënë që e ka notën mesatare 10 dhe e ka fituar bursën. Ndërsa, këtë vit si kusht e kemi vendosur që së paku t'i ketë provimet e vitit të parë për ta fituar bursën me këtë kriter (100€ në muaj). Studentët që këtë vit i kanë filluar studimet, futen në grupin e bursave 60€ në muaj. Për momentin, nga aplikantët deri më tani, nuk kemi ende të kategorisë me notën 10.

Zonja Vlorë, unë kam qenë te shkolla "Gëzim Hamza" – Piktori dhe i kam marrë të gjitha fotografitë e nyjeve sanitare. Para një viti e gjysmë është bërë renovimi i tyre, kanë qenë në nivel, por tani janë dëmtuar. Do të marrim masa, sepse jemi në proces të një kontrate të re për nyje sanitare. Kam qenë gjithashtu edhe te shkolla e Celinës.

Atdhe Rama: Faleminderit, kryesues! Lirigzon, të falënderoj për pyetje dhe besoj që në seancën e radhës do ta pranosh një përgjigje të detajuar. Sa i përket fushës në Nagac dhe turneut që do të mbahet atje. Kam pasur kontakt me organizatorët dhe besoj që gjatë kësaj jave do ta shikojmë se në çfarë mund të intervenojmë atje. Nëse përmbaruesi nuk ka tërheq paratë, atëherë, do të rregullohen të gjitha fushat që janë të dëmtuara.

Behar Thaqi: I nderuar kryesues, nënkryetar, kolegë drejtorë, asambleistë. Në pyetjen e Lirigzon Kastratit në lidhje me rrugët fushore: Duke u bazuar në kërkesën e këshillit të Hoçës së Vogël, si drejtor kam ndërmarrë veprime fillestare duke dalë në terren së bashku me kryetarin e fshatit dhe asambleistin Lirigzon Kastrati. Me këtë vizitë kemi arritur pajtueshmëri që të intervenohet në dy rrugë fushore, me qëllim të përmirësimit të qasjes dhe kushteve për banorët. Mirëpo, ne nuk mund të paragjykojmë në punimet e operatorit, i cili e ka një organ mbikëqyrës dhe është dashur që nga banorët e fshatit operatori të lejohet të veprojë, si dhe nëse nuk do ta rregullonte rrugën në bazë të normave të caktuara, atëherë si banorë keni pasur të drejtë t'i ndërpreni punimet. Ne jemi për rregullimin e rrugëve, mirëpo gjithnjë në bazë të ligjit.

Përparim Krasniqi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë anëtarët e kuvendit, të nderuar kolegë dhe ju asambleistë. Për bacën Sali: Unë, më datë 20 prill ju kam dërguar të gjitha përgjigjet që janë adresuar nga seanca e kaluar, përmes zyrës së kuvendit. Pyetja ka qenë lidhur me ndriçimin publik, gjatësia është 470m prej Malësisë deri aty, gypin nëntokësor e kemi instaluar, por nuk kemi shtylla metalike të ndriçimit publik për atë pjesë, por në anën e djathtë janë gypat e betonit dhe mund ta vendosim ndriçimin publik aty pa problem. Rreth kanalizimit aty është pak më komplekse në Malësi, gjithashtu edhe te çështja që e ka ngritur Behluli për dy lagjet në fshatin Senoc. Besoj që me Grantin e Performancës do ta shpallim një projekt të ri dhe të vazhdojmë me instalimin e këtyre kanalizimeve. Për moment nuk kemi kontratë të kanalizimit. Doktor pyeti rreth dëmtimit të rrugëve: Dëmtimin e rrugëve e ka bërë KRU Gjakova dhe besoj që shumë shpejt do të rregullohet, sepse e kanë obligim kthimin në gjendjen e mëparshme. Sa i përket idesë së nënkalimit te shkolla "Isa Boletini", është projekt që duhet të analizohet, sepse ekziston edhe një plan i mobilitetit që ekspertët e komunikacionit e parashohin situatën. Sidoqoftë, aty bëhet ngarkesë e madhe nga rruga njëkahëshe. Behluli pyeti rreth rrugës "Tafil Zyberaj", Rahovec-Drenoc-Sarosh. E kemi në kontratë trajtimin e kësaj rruge dhe e kemi marrëveshjen me Ministrinë e Infrastrukturës. Problemin më të madh aty e kemi me KRU Gjakovën, të cilët e kanë hapur një procedurë për vendosjen e gypave jashtë trupit të rrugës. Melinda pyeti për rrugën "Xhafer Nurkasa". Melindë, të kam dërguar përgjigje në email, por ndoshta nuk e ke parë. Kjo rrugë është pjesë e projektit të 15 rrugëve në qytet. Në këtë rrugë duhet të bëhet edhe kanalizimi dhe në momentin që Ministria e Infrastrukturës i lëshon mjetet, menjëherë do ta fillojmë punën. Defrim Kafexhiu pyeti për dy rrugë: Është Ministria e Infrastrukturës ajo që i ka bllokuar mjetet dhe ende nuk ia kemi filluar procesin në ato dy segmente

rrugore. Yllka, problemi është te KEDS-i, sepse po e bën zëvendësimin e shtyllave të betonit. Kanë mbetur edhe dy lagje për zëvendësimin e dritave. Në momentin që Keds-i e përfundon instalimin e shtyllave, ne vazhdojmë me instalimin e ndriçimit publik.

Bujar Mustafa: A është problemi i njëjtë edhe me rrugën, Celinë – Fortesë?

Përparim Krasniqi: Kur ka qenë zv. ministër Hysen Durmishi, e kemi bërë një marrëveshje për financimin e këtij projekti me vlerë 650.000€ dhe në momentin që ka ardhur ministri i ri e ka pezulluar, tani ende nuk e kemi një marrëveshje të re. Përndryshe, ne e kemi proceduar dhe jemi duke pritur.

Kryesuesi: Në fund, e kam pranuar një email prej Demos-it, për monitorimin e punës së kuvendarëve dhe kanë kërkuar një pëlqim formal prej kuvendarëve, që ta bëjnë monitorimin edhe të kuvendit komunal të Rahovecit. Nëse jeni të pajtimit, unë po ua kthej një përgjigje pozitive. Ju falënderoj për kontributin, shihemi në seancën e radhës.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi



KRYESUESI

Fatmir Iska